



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade
Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë

SKEMA E GRANTEVE

Udhëzues për Aplikim: Thirrja Publike për Përkrahjen Financiare të Ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM) në sektorin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)

Autoriteti kontraktues dhe zbatues: Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), respektivisht Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA).

1. Hyrje

MINT përmes KIESA, lanson skemën e granteve për mbështetjen e NMVM-ve që operojnë në sektorin e TIK-ut. Kjo skemë synon të përkrahë zhvillimin e qëndrueshëm, inovativ dhe të orientuar drejt tregjeve ndërkombëtare të këtij sektori në Kosovë.

2. Qëllimi

Skema ka për qëllim mbështetjen e NMVM-ve në sektorin e TIK-ut që paraqesin propozime për krijimin e produkteve të reja apo zhvillimin dhe përmirësimin e produkteve ekzistuese, me fokus në rritjen e mundësive për eksport.

3. Sektori

Të drejtë aplikimi kanë NMVM-të që e kanë veprimtarinë e tyre primare ose sekondare në sektorin e TIK-ut.

4. Përkrahja financiare e ofruar nga MINT/KIESA

Shuma totale e skemës së grantit është 1,000,000€. MINT/KIESA rezervon të drejtën të mos shpërndajë të gjitha mjetet e disponueshme. Grantet do të ndahen për NMVM-të, me një vlerë maksimale deri në 25,000€ për përfitues. Çdo tejkalim i kësaj vlere duhet të mbulohet nga vetë bizneset përfituese.

5. Dokumentet e kërkuara për aplikim sipas Udhëzimit Administrativ 01/2018

1. Certifikatën e regjistrimit të biznesit me të gjitha informatat përcjellëse sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.
2. Certifikatën e numrit fiskal (nuk aplikohet për bizneset të cilat numrin e regjistrimit të biznesit dhe numrin fiskal e kanë në një certifikatë).
3. Vërtetim tatimor me të cilën vërtetohet se aplikuesi nuk ka borxhe aktuale tatimore të pashlyera apo obligime tjera tatimore ose është në marrëveshje për shlyerjen e borxhit me ATK.

4. Kopjen e letërnjoftimit të personit/ve në emër të cilit/ve është i regjistruar aplikuesi.
5. Dëshmi nga aplikuesi se nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor të lëshuar nga Gjykata Themelore - kërkohet origjinali jo më i vjetër se 30 ditë. Dokumenti mund të nxirret në Gjykatën Komerciale të Kosovës.
6. Dëshminë e xhirollogarisë aktive në emër të biznesit aplikues në njërin prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës. Dëshmia duhet të jetë brenda afatit të hapjes së thirrjes.
7. Gjendjen e xhirollogarisë bankare në emër të biznesit aplikues për vitin e fundit (2024). Për aplikuesin e sapo themeluar kjo nuk është e aplikueshme.
8. Të mos ketë pranuar mjete nga burimet tjera të financimit për të njëjtat aktivitete (e dëshmuar me deklaratë nën betim, e cila duhet shkarkuar nga ueb faqja e KIESA-se, të plotësohet me të dhënat e biznesit dhe e njëjta të ngarkohet në sistemin e-Kosova).
9. Të kenë kryer të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit nga MINT për dy vitet e fundit, (e dëshmuar me deklaratë nën betim, e cila duhet shkarkuar nga ueb faqja e KIESA-se, të plotësohet me të dhënat e biznesit dhe e njëjta të ngarkohet në sistemin e-Kosova).
10. Projekt propozimi duhet të përfshijë aftësitë kryesore organizative si: qëllimin, aktivitetet e projektit, si dhe strukturën organizative të aplikuesit. Për më tepër, vlera e shtuar e projekt propozimit bazohet në një plan kohor konkret dhe profesional për realizimin e projektit, duke përfshirë këtu konceptin inovativ për krijimin e produkteve të reja apo zhvillimin dhe përmirësimin e produkteve ekzistuese, të shoqëruara me koston financiare për secilin aktivitet. Po ashtu, projekt propozimi duhet të paraqes edhe potencialin për zgjerimin e tregut si dhe kapacitetin për zbatimin e projektit. Projekt propozimi duhet të përgatitet nga subjekti aplikues dhe të ngarkohet në platformën e-Kosova.
11. Një video me kohëzgjatje deri në 2 minuta që paraqet konceptin e projekt propozimit.

Sqarime shtesë :

- Aplikimet pranohen në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.
- NMVM-të që kanë marrë mbështetje financiare direkte nga MINT/KIESA gjatë vitit 2024 në kuadër të Skemës së Granteve për Inovacion, nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga kjo thirrje, përfshirë edhe në ndonjë skemë tjetër të KIESA-së gjatë vitit 2025, përveç Skemës për Shërbime të Digjitalizimit.
- Bizneset përfituese do të lidhin marrëveshje dypalëshe me MINT/KIESA, pjesë e secilës do të jenë edhe deklaratimet që janë bërë me rastin e aplikimit.
- Fushë veprimtaria primare ose sekondare e ndërmarrjeve nuk pranohet të ndryshohet në ARBK pas shpalljes së thirrjes publike. Po ashtu, për bizneset përfituese pas shpalljes së listës preliminare deri të realizimi i pagesës nuk lejohet asnjë ndryshim në ARBK.
- Para nënshkrimit të marrëveshjes, ndërmarrjet përfituese obligohen të sjellin garancion nga kompanitë e sigurimit apo bankat, për vlerën totale të grantit.
- Pas nënshkrimit të marrëveshjes, ndërmarrjes përfituese do t'i transferohen 100% e vlerës së aprovuar.
- TVSH është shpenzim i pranueshëm për persona fizik dhe ndërmarrjet jo deklaruese të TVSH-së, ndërsa për ndërmarrjet që janë deklaruese të TVSH-së, ky është shpenzim i papranueshëm.

- Përfitues do të jenë bizneset e renditura më pikët më të larta nga komisioni vlerësues. Varësisht nga limitet buxhetore, lista e bizneseve përfituese mund të parasheh deri në 10 biznese rezervë.
- Lista e bizneseve përfituese do të publikohet në faqet zyrtare të MINT dhe KIESA.
- Me këtë thirrje përjashtohen nga ky proces kompanitë konsulente që ofrojnë shërbime për bizneset aplikuese. Në rast të identifikimit të përfshirjes së tyre si përfaqësuese të bizneseve, aplikuesit do të diskualifikohen. Kjo për arsye se i gjithë procesi është i thjeshtë dhe pa kosto financiare, duke filluar nga mënyra elektronike e aplikimit përmes platformës e-Kosova, e deri të vlerësimi, nënshkrimi i marrëveshjeve, disbursimi i mjeteve dhe monitorimi i tyre.

6. Kohëzgjatja

Afati maksimal për realizimin e projektit është 12 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës. Bizneset janë të obliguara të raportojnë të paktën 30 ditë para skadimit të marrëveshjes.

7. Si të aplikohet

- Njoftimi për thirrje publike është i publikuar në ueb faqen zyrtare të MINT dhe të KIESA:

🔗 <https://mint.rks-gov.net/>

🔗 <http://kiesa.rks-gov.net/>

- Aplikimi bëhet vetëm përmes platformës e-Kosova <https://ekosova.rks-gov.net/640>
- Afati për aplikim: nga data 17.06.2025 deri më 07.07.2025.
- Informatat shitesë mund të merren përmes email adresës: sme.kiesa@rks-gov.net

#	8. Kriteret e vlerësimit	Pikët maksimale
1	Rëndësia e projekt propozimit për krijimin e produkteve të reja apo zhvillimin dhe përmirësimin e produkteve ekzistuese	deri në 50 pikë
2	Potenciali për zgjerimin e tregut	deri në 20 pikë
3	Kapaciteti për zbatimin e projektit	deri në 20 pikë
4	Ndikimi Social dhe Ekonomik: Numri i vendeve të reja të punës të parashikuara për t'u krijuar gjatë dhe pas përfundimit të projektit.	deri në 10 pikë
#	Totali	deri në 100 pikë

9. Ankesat

Pas publikimit të rezultateve preliminare, aplikuesit mund të dorëzojnë ankesa vetëm përmes platformës e-Kosova, brenda afatit të përcaktuar sipas UA 01/2018..

Shënim:

- Nëse vërtetohet se informacionet e paraqitura në aplikacion janë të pasakta, përfituesit nuk do t'u bëhet pagesa dhe do të mbajnë përgjegjësi sipas legjislacionit në fuqi.
- Të gjitha zotimet lidhur me të dhënat e ofruara që do të përdorën tek kriteret e vlerësimit duhet të pasqyrohen nga aplikuesit në projekt-propozim dhe të njëjtat të dhëna do të jenë pjesë përbërëse e marrëveshjes.